



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
9-od-3578	2	02.05.2015



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/46;
Datë: 29.04.2015 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 29.04.2015 nxjerrë:

V E N D I M

për

hapjen e diskutimit publik të projekt Planit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe katastrofat tjera në komunën e Junikut

I. Me këtë vendim hapet diskutimi publik për projekt Planin për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe katastrofat tjera në komunën e Junikut/në tekstin e mëtejme projekt Planit/.

II. Projekt Plani nga pika I. e këtij vendimi vihet në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.

III. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.

IV. Ekspozimi i projekt Planit do të bëhet në zyrën e inspektionit e cila gjendet në kuadër të objektit të Komunës së Junikut.

V. Diskutimi publik i projekt Rregullores zgjat 15 ditë (fillon më: 04.05.2015 dhe përfundon më: 18.05.2015).

VI. Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Plani ekspozohet edhe në ueb faqen e Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.

VII. Diskutimi publik i projekt Planit organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim.

VIII. Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të këtij projekt Plani.

IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim .

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270
<http://kk.rks-gov.net/junik>

X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut.

XII. Vendimi iu dërgohet:

1. Kryetarit të Komunës së Junikut;
2. Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojte dhe Shpëtim;
3. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
4. Shërbimit të Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivit të Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://kk.rks-gov.net/junik>